



06 PRILL 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 06 Prill 2020.

## Përmbajtja

Akt Normativ Nr. 12, datë 02.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të pagesave të qerasë”.....	1
Urdhër Nr. 208, datë 30.03.2020 “Për një ndryshim në Urdhër Nr. 193 datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” - Hapja e tre aktiviteteve të tjera tregtare.....	3
Urdhër Nr. 216, datë 01.04.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve”.....	4
Akt Normativ Nr. 13, datë 02.04.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përbarimor gjyqësor, ndërmjetësisimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë shkaktuar nga COVID-19”.....	4
Aplikimi për ankesa në lidhje me zbatimin e Urdhrit datë 17.03.2020, të Kryeministrit të Shqipërisë dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, mbi shtyrjen e afatit të pagesave të kësteve të kredive. ....	5

## Akt Normativ Nr. 12, datë 02.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të pagesave të qerasë”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Akt Normativ Nr. 12, datë 02.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të pagesave të qerasë”](#)

***Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 01.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të pagesave të qerasë”.*** Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 01.04.2020 “Për shtyrjen e afateve të pagesave të qerasë”](#)

Të gjithë qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës-qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, që kanë kontratë pune por e kanë pezulluar/zgjidhur atë si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, Prill dhe Maj 2020.



Të gjithë qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, Prill dhe Maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14'000'000 (katërbëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, Prill dhe Maj 2020.

Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020.

Të gjithë qiramarrësit e përcaktuar në këtë pikë, të cilët kanë ankesë për qiradhënësin si pasojë e moszbatimit të detyrimeve të mësipërme, do t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet komunikimit elektronik. Qiradhënësit, të cilët nuk e zbatojnë këtë pikë, dënohen me gjobë në masën e pesëfishit të qirasë mujore përkatëse.

Me qëllim të përfitimit të lehtësive të parashikuara në Aktin Normativ dhe për vendimmarrje të mëtejshme të Këshillit të Ministrave, të aplikojnë me procedurat si më poshtë:

Individët qiramarrës dhe studentët qiramarrës, duhet të aplikojnë në adresën e email qirajaim@tatime.gov.al, sipas Formularit Nr. 1 në rastet kur marrëdhënia midis palëve është Individ me Individ ose sipas Formularit Nr. 2 kur marrëdhënia midis palëve është Individ me Tatimpagues. Në çdo rast aplikimit i duhet bashkëlidhur kopje e kontratës së qirasë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktuale.

Personat fizikë/juridikë të regjistruar, duhet të aplikojnë në llogarinë e tyre në e-filing, tek menuja “Çështjet e mia”, duke ngarkuar Formularin e aplikimit Nr. 3, kur marrëdhënia midis palëve është Tatimpagues me Tatimpagues ose sipas Formularin Nr. 4 kur marrëdhënia është Tatimpagues me Individ. Në çdo rast aplikimit i duhet bashkëlidhur kopje e kontratës noteriale të qirasë.



Të gjithë qiramarrësit e përcaktuar më lartë në këtë njoftim, të cilët kanë ankesë për moszbatim të Aktit Normativ nga ana e qiradhënësit, pasi të kenë plotësuar të gjithë procedurën më sipër, të dërgojnë një email në adresën [ankesa.qirajaim@tatime.gov.al](mailto:ankesa.qirajaim@tatime.gov.al), me objekt/titull të Email-t, NIPT në rastin e Personave fizikë/juridikë të regjistruar, dhe NID (Numri Unik i Identifikimit) të Letërnjoftimit në rastin e individëve apo studentëve, duke përshtuar arsyen e ankesës.

Formularët mund t'i shkarkoni në linkun e mëposhtëm:

[\*\*Formularët\*\*](#)

[\*\*Urdhër Nr. 208, datë 30.03.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 193 datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” - Hapja e tre aktiviteteve të tjera tregtare.\*\*](#)

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[\*\*Urdhër Nr. 208, datë 30.03.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 193 datë 20.03.2020 Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”\*\*](#)

Nëpërmjet këtij Urdhri, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bërë këto ndryshime në tabelën e aktiviteteve të lejuara:

- Gomisteri – Lejohen
- Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara – Lejohen
- Shitje me pakicë për kancelari dhe pajisje të zyrës – Lejohen



Urdhër Nr. 216, datë 01.04.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Urdhër Nr. 216, datë 01.04.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve”.](#)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar mbylljen e institucioneve publike dhe jo publike jo më deri më datë 23 mars 2020 por deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19. Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike e jopublike të cilat nuk e mbyllin aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar dënohen me gjobë në vlerën 5’000’000 lekë për institucionet arsimore dhe në masën 1’000’000 lekë për çerdhet dhe kopshtet, publike/jopublike. Në rast përsëritje do të aplikohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.

Akt Normativ Nr. 13, datë 02.04.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë shkaktuar nga COVID-19”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Akt Normativ Nr. 13, datë 02.04.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë shkaktuar nga COVID-19”](#)

Pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përmbartuesit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësit dhe administratorit në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

Rregullat e përcaktuara më sipër, nuk zbatohen në këto raste:



- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga çështje familjare, me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim;
- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes;
- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt masat e sigurimit të padisë për çështje administrative dhe për çështjet civile, në të cilat gjykata ka dhënë vendim për sigurimin e padisë ose vendim me ekzekutim të përkohshëm, kur nga vonesa e ekzekutimit ose e kryerjes së veprimeve procedurale bëhet i pamundur ekzekutimi i këtyre titujve ekzekutivë, pas përfundimit të gjendjes së epidemisë;
- Nëse është e domosdoshme shmangia e dëmtimit të masës së falimentimit;
- Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

### **[Aplikimi për ankesa në lidhje me zbatimin e Urdhrit datë 17.03.2020, të Kryeministrit të Shqipërisë dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, mbi shtyrjen e afatit të pagesave të kësteve të kredive.](#)**

Në zbatim të Urdhrit të Bankës së Shqipërisë, datë 17.03.2020, të nënshkruar nga Kryeministri i Shqipërisë dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, mbi shtyrjen e afatit të pagimit të kësteve të kredive për biznese dhe individë deri në datën 31.05.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, i bën thirrje të gjithë kredi marrësve të cilët kanë ankesë për moszbatim të këtij Urdhri, të dërgojnë një email në adresën [ankesa.kredia@tatime.gov.al](mailto:ankesa.kredia@tatime.gov.al).

Kredi marrësit përfitues duhet të argumentojnë përballjen me vështirësitë e hasura si pasojë e situatës së shkaktuar nga COVID-19, duke plotësuar formularin bashkëlidhur këtij njoftimi.

Formularin mund t'i shkarkoni në linkun e mëposhtëm:

[Formulari – Ankesë Kredie](#)